

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e tetë të mbajtur më 28.12.2021 miratoi

Vendim

Procedura e kontrollit të fletës anketuese të _____, ish Kryetari i Gjykatës Themelore _____ NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-1304/1 datë 22.02.2020.

Lënda me numër 08 –1304/1 të datës 22.02.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-1304/1 e datës 22.02.2020 për kontrollimin e fletës anketuese të _____, kryetar i Gjykatës Themelore _____ është formuar sipas Planit Vjetor për monitorimin e gjendjes pasurore dhe interesave për vitin 2020.

Pas shqyrtimit të evidencës, KSHPK-ja konstatoi se personi _____ në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas zgjedhjes për kryetar të Gjykatës Themelore _____ ka dorëzuar fletën anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Të dhënat për të emëruarën dhe familjarët e saj janë kërkuar nga Agjencia për Kadastrën e Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Brendshme, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Depozita Qendrore e Letrave me Vlerë. Njëkohësisht është bërë kontroll në sistemin e shpërndarjes së Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas krahasimit të të dhënave të marra me të dhënat e deklaruara në fletën anketuese e të emëruarës, u konstatua se **nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.**

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Nikolina Tarçullovskaja-Miloshevskaja, këshilltare
Miratoi: Sofka Pejovskaja Dojçinovskaja, anëtare



КОМИСИОНА СХТЕТРОР
ПЕР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАР,
Билјана Ивановска